Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve në administratën shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11) si dhe në bazë të nenit 25 paragrafi 2 dhe paragrafi 5 të Ligjit për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 103/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 dhe 64/18) ministri i Arsimit dhe Shkencës përcaktoi Programin mësimor për **arsim muzikor** për klasën IX (nëntë) në arsimin fillor nëntëvjeçar.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Programi mësimor

# ARSIMI MUZIKOR

klasa IX (nëntështatë)

arsimi fillor nëntëvjeçar

Shkup, 2019

| | |
|---|---|
| **Titulli i programit mësimor** | Arsimi muzikor |
| **Lloji i programit mësimor** | I detyrueshëm |
| **Viti mësimor** | klasa VII (shtatë) |
| **Numri i orëve javore/vjetore për realizimin e programit mësimor** | 1/36 |
| **Temat mësimore të programit mësimor** | ▪ **AKTIVITETE INTERPRETIMI** (këndim, ekzekutim në instrumentet muzikore për fëmijë dhe veprimtaria)<br>▪ **DËGJIMI I MUZIKËS**<br>▪ **SHKRIMLEXIMI MUZIKOR**<br>▪ **VEPRIMTARIA MUZIKORE POPULLORE – Tradita dhe zakonet**<br><br>MBANI MEND! Mësimdhënësit çdo herë mund të bëjnë përzgjedhjen e tyre të këngëve dhe kompozimeve për këndimin dhe dëgjimin e muzikës duke përdor propozim-listën e dhënë në programin mësimor. |

# HYRJE

Muzika si pjesë kryesore integruese e kulturës dhe jetës së njeriut zë vend të rëndësishëm në procesin e edukimit dhe arsimimit. Arsimi muzikor është lëndë e detyrueshme për nxënësit prej klasës I deri të IX dhe përfshihet me 2 (dy) orë prej klasës I deri në klasën V dhe me 1 (një) orë prej klasës VI deri në klasën IX.

Qëllimi i mësimit në arsimin muzikor është që nxënësit të zhviillojnë dashurinë ndaj muzikës, të njihen me karakteristikat themelore të muzikës përmes përvojës personale që të mund t'i kuptojnë dhe përjetojnë veprat muzikore, të marrin pjesë në jetën muzikore në shkollë dhe jashtë saj.

Që të realizohet qëllimi i mësimit nxënësit do të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme: këndim, ekzekutim, njohje me krijimtarinë popullore, dëgjim të muzikës nga autorë të vendit dhe të jashtëm, si dhe muzika nga të gjithë popujt të cilët jetojnë në vendin tonë. Përmes njohjes së kulturës muzikore botërore dhe vendore, si dhe krijimtaria muzikore popullore e popullit të vetë dhe popujve tjerë të cilët ejtojnë në vendin tonë dhe përmes muzikës praktike nxënësit do t'i pasurojnë përvojat e tyre dhe njohuritë si dhe do t'i zhvillojnë aftësitë e veta muzikore. Nxitja e kreativitetit të nxënësve është element, segment shumë i rëndësishëm në mësim dhe për këtë duhet t'ju mundësohet të marrin pjesë në aktivitetet muzikore në klasë dhe në shkollë, ndërsa nxënësit e talentuar të marrin pjesë në ansamblet shkollore muzikore (kor, orkestër etj).

Lënda mësimore për arsim muzikor ka integrim të jashtëm me lëndët tjera mësimore: arsimi qytetar, gjuhë amtare, matematikë etj. Vend të rëndësishëm duhet të ketë zbatimi i TIK në mësim në arsimin muzikor i cili mundëson mënyrën interesante dhe aplikative të nxënësve të arrin njohuri dhe shkathtësi të reja.

Në periudhën e dytë zhvillimore arsimi muzikor vazhdon ta realizojë ndikimin e tij kompleks mbi zhvillimin e personalitetit të fëmijëve, duke i nxitur emocionet dhe aktivitetin intelektual, duke arritur ndjenja estetike dhe tipare pozitive morale, kreativitet dhe pavarësi, vetëbesim dhe vetëdije për vlerën e tyre, duke i liruar nxënësit nga stresi dhe ngarkesa.

## QËLLIMET E MËSIMIT NË KLASËN IX

Nxënësi/nxënësja:

- të zbatojë interpretim të drejtë vokal;
- ta zhvillojë ambitusin e zërit a e vogël – d2;
- të këndojë këngë me vija të ndryshme melodike, të ndryshme për nga karakteri dhe përmbajtja në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën e popujve të cilët jetojnë në vendin tonë;
- t'i njohë veprat muzikore - skenografike;
- t'i njohë karakteristikat dhe rolet e muzikës së filmit;
- të zotërojë shkallën F-dur (teorike dhe sipas dëgjimit);
- të zotërojë shkallën d-moll/të llojit natyror, harmonik dhe melodik (teorike dhe sipas dëgjimit);
- të këndojë dhe ekzekutojë ushtrime ritmike dhe melodike me vlera të ndryshme të notave dhe pushime në taktin e masës së thjeshtë dhe të përbërë 5/8, 7/8 dhe 9/8;
- të dëgjojë dhe ekzekutojë figurën ritmike sinkopë;
- të aplikojë shkrimin e notave në aktivitetet e interpretimit muzikor;
- t'i njohë traditat e popullit maqedonas dhe të popujve të cilët jetojnë në vendin tonë;
- të njihet me zbatimin e krijimtarisë muzikore popullore në zhanret e muzikës moderne;
- të inkurajohet në shprehjen e tij/saj muzikore;
- të përdorë TIK për aktivitetet kreative, prezantime, njohjen me bazat,shkrimleximin e muzikës etj.

| | TEMA 1. AKTIVITETET E PERFORMIMIT (10 orë)<br>(këndimi, ekzekutimi i instrumenteve muzikore për fëmijë dhe shprehjet muzikore dhe krijimtaria) | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr. ren.** | **Rezultatet e mësimit** | **Përmbajtjet dhe nocionet** | **Aktivitetet dhe metodat** | **Standardet e vlerësimit** |
| **1.** | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>-sqaron për përmbajtjen e këngës dhe diskuton për karakterin e këngës;<br><br>-këndon këngë sipas dëgjimit dhe notave dhe të ndryshme për nga karakteri dhe përmbajtja;<br><br>-realizon interpretimin e drejtë vokal. | **Përpunimi i këngëve për fëmijë, këngëve artistike, popullore me ambitus a e vogël- e2 sipas dëgjimit dhe me zbatimin e tekstit total** | **Aktivitetet**<br><br>**Këndimi i këngëve sipas dëgjimit:**<br>**-**demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi;<br>- përgatitja e tekstit letrar dhe diskutimi rreth përmbajtjes, fjalëve të panjohura, karakterit etj.;<br>- këndimi me rrokje neutrale;<br>- këndimi në fraza, fjali dhe strofa (mësimdhënës-nxënës);<br>-këndimi i këngës së plotë individualisht, në grupe etj., me shprehje artistike.<br><br>**Këndimi me zbatimin e përshkrimit notal:**<br>-leximi dhe diskutimi për tekstin letrar (përmbajtja, fjalë të panjohura, karakteri);<br>-sqarimi i tekstit notal;<br>- realizimi parlato (leximi ritmik të tekstit notal);<br>- këndimi në rrokje neutrale;<br>-këndim me solmizim së bashku me mësimdhënësin;<br>-këndim me kombinimin e solmizimit dhe rrokjes neutrale;<br>-këndim me tekst me shprehje artistike. | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>**Sipas dëgjimit:**<br>1.1. këndon këngë në rrokje neutrale;<br><br>1.2. këndon këngën e plotë në grup me tekst letrar;<br><br>1.3. këndon këngën e plotë në grup, me shprehje artistike.<br><br>**Sipas tekstit notal:**<br>1.1.1.sqaron tekstin notal (shenja për taktin, kohëzgjatjen e tneve, emrat e toneve etj.).<br>1.1.2.realizon parlato lexim ritmik të tekstit notal);<br>1.1.3.këndo sipas tekstit notal me solmizim, rrokje neutrale dhe tekst në ritëm të caktuar dhe intonacion. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | **Shembuj për të gjitha gjuhët:**<br><br>**„Imagine“-**J.Lennon and P. McCartni**/„Замисли“** realizojnë Xh. Lenon dhe P. Makartni (sipas dëgjimit).<br><br>**„What a wonderful world“**–Luis Armstrong **/„Çfarë bote e mrekullueshme“** realizon L. Armstrong (sipas dëgjimit)<br><br>**„Kori i fshatarëve“** nga opera **„Nusja e shitur“** – B. Smetana (sipas notave)<br>- **festa 11 Tetori (gj. maq.)**<br><br><br>**<u>Këngë maqedonase:</u>**<br>**-„Не стој доне Донке“ -** popullore (sipas dëgjimit) 32 fq.<br>**-„На срце ми лежи, мила мамо“** (sipas notave)<br><br>**<u>Këngë shqipe:</u>**<br>**-„O sa gëzim“/**„ Sa gëzim“– popullore (sipas dëgjimit)<br><u>https://www.youtube.com/watch?v=uyYXca1En0k</u><br>**-„Nënë Tereza“/**„Мајка Тереза**“** (sipas notave)<br><br>**<u>Këngë turke:</u>**<br>**-„Manastırın ortasında“**/„Në mes të | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | Manastirit“ (sipas dëgjimit)<br>**-„Kelebek“ /**„Flutura“(sipas notave)<br><br>__Këngë rome:__<br>**-„Alo dive romano“**/„Erdhi dita e romëve“ (sipas dëgjimit);<br>**-„Erdelezi“/„Shën Gjergji“** (sipas notave).<br><br>__Këngë serbe:__<br>**-„Што се боре мисли мое“/**„Për çka luftojnë ndjenjat e mia“ (sipas dëgjimit);<br>- **„Ко удара тако позно“/**„Kush godet kaq vonë“ (sipas notave).<br><br>__Këngë vllahe:__<br>**-„Cãntic ti protlu aftumubilu“/**„Kënga për automjetin e parë’’ (sipas dëgjimit);<br>**-„Tanca a mea, Tanca a li dade“/**„Tanka ime, Tanka dashuria e nënës“ (sipas notave).<br><br>__Këngë boshnjake:__<br>**-„Sumrak“ - L.V.Betoven** (sipas dëgjimit);<br>**-„Hajdmo sad veselo“/**„Ejani tash gëzueshëm“ (sipas notave)<br><br>**MBANI MEND!** Para se të përpunohet kënga (sipas dëgjimit ose me zbatimin e tekstit notal) nxënësit duhet të këndojnë. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | Në të gjitha etapat e përpunimit të këngës mund të këndohet në mënyrë kolektive, individuale, në grupe, me dhe pa shoqërimin instrumental.<br>Për aktivitetet e interpretimit nxënësi/nxënësja vlerësohet sipas aktivitetit të treguar, e jo sipas nivelit të zhvillimit të dëgjimit, zërit këndues dhe aftësive motorike. | |
| **2.** | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>-këndon/ekzekuton (tërësi të ndryshme muzikore ) në F-dur dhe d-moll;<br><br>-këndon/ekzekuton ushtrime ritmike dhe melodike me vlerat dhe pauzat e notave të mësuara në taktin 2/4, 3/4, 4/4 (kryesisht sinkopë) dhe taktin e përbër 5/8, 7/8 dhe taktin 9/8 . | **Interpretimi i ushtrimeve i tërësive të ndryshme muzikore në F-dur dhe d-moll me zbatimin e vlerave të notave të mësuara në taktet e masës së thjeshtë (kryesisht sinkopë) dhe taktin e masës së përbërë 5/8, 7/8 dhe taktin 9/8.** | **Aktivitetet**<br><br>-Këndimi i tërësive muzikore të ndryshme (në rrkje neutrale, me tekst, me nota) sipas dëgjimit.<br><br>-Ekzekutimi i tërësive muzikore të ndryshme në instrmentet muzikore për fëmijë sipas dëgjimit dhe notave.<br><br>**-**Këndimi dhe ekzekutimi **i ushtrimeve ritmike dhe melodike me vleratdhe pushimet e notave të mësuara në taktin** 2/4, 3/4, 4/4 (kryesisht sinkopë) dhe taktin e përbërë 5/8, dhe 7/8 dhe taktin 9/8 .<br><br>- Lojëra muzikore (pyetje – përgjigje, eko, plotësim etj.) | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>2.1. ekzekuton/këndon motive dhe fraza në ritëm dhe intonacion të caktuar sipas dëgjimit;<br><br>2.2. ekzekuton/këndon ushtrime në ritëm dhe intonacion të caktuar sipas dëgjimit;<br><br>2.3. ekzekuton/këndon motive dhe fraza me aplikimin e instrumenteve muzikore për fëmijë në ritëm dhe tone të caktuara prej a e vogël deri e2;<br><br>2.4. ekzekuton/këndon ushtrime me aplikimin e instrumenteve muzikore për fëmijë me vlerat dhe pushimet e notave të mësuara në taktin 2/4, 3/4, 4/4 (kryesisht sinkopë) dhe taktin e masës së përbërë 5/8, 7/8 dhe taktin 9/8. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **3.** | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>- përdor instrumentet ritmike dhe melodike për fëmijë për ekzekutimin e intervaleve dhe elementeve tjera nga shkrimleximi muzikor në shembujt muzikor;<br><br>- ai këndon këngë të shoqëruara me instrumente ritmike dhe melodike për fëmijë dhe zgjidh rebuse muzikore, fjalëkryq etj. | **Interpretimi muzikor i nxënësve përmes elementeve të mësuara nga shkrimleximi muzikor** | **Akivitetet**<br><br>-Shoqërimi i këngëve të mësuara me instrumentet ritmike dhe melodike për fëmijë.<br>-Krijimi i melodive të zakonshme të shkurta.<br>-Këndimi dhe ekzekutimi i melodive të zakonshme me zbatimin e intervaleve: kuarta, kuinta, seksta dhe septima me instrumentet ritmike dhe melodike për fëmijë.<br>-Lojërat muzikore, dramatizimet, zgjidhja dhe përpilimi i rebuseve muzikore, fjalëkryqeve etj.<br><br>**Mbani mend!**<br>Në krijimin e tërësive muzikore dhe zgjidhjes së rebuseve, fjalëkryqeve etj., mund të përdoren TIK.<br>Temat mësimore: Dëgjimi i muzikës, Shkrimleximi muzikor dhe krijimtaria popullore integrohen në aktivitetet ku mësimdhënësi ka mundësinë të aftësojë/ndryshojë numrin e përgjithshëm të orëve sipas afiniteteve, aftësive, interesit nevojave të nxënësve.<br>**Metodat:**<br>• demonstrative;<br>• dialog ose metoda dhe biseda;<br>• punë praktike;<br>• punë krijuese. | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>3.1. ekzekuton/këndon motive dhe fraza në ritëm dhe intonacion të caktuar sipas dëgjimit;<br><br>3.2.shkruan melodi të zakonshme sipas udhëzimeve të dhëna me zbatimin e njohurive të shkrimleximit muzikor;<br><br>3.3. këndon/ekzekuton melodi të zakonshme të shkurtëra me zbatimin e përmbajtjeve me instrumentet ritmike dhe melodike për fëmijë;<br><br>3.4. përdor elemente nga shkrimleximi muzikor për zgjidhjen dhe përpilimin e rebuseve muzikore, fjalëkryqeve etj. |

| | TEMA 2. DËGJIMI I MUZIKËS (16 orë) | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr. Ren.** | **Rezultatet e mësimit** | **Përmbajtja dhe nocioni** | **Aktivitetet dhe metodat** | **Standardet e vlerësimit** |
| **1.** | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>-sqaron për veprat e skenës muzikor;<br>-dëgjon fragmente të veprave në skenën muzikore;<br><br>- di tituj të veprave të skenës muzikore. | **Njohja me veprat e skenës muzikore**<br>**- opera**<br>**- operetë**<br>**- balet**<br>**- mjuzikëll**<br><br>**Fragment nga opera:**<br>**Dueti i Papageno dhe Papagena"** nga opera „Flauta magjike" – V.A. Mocart<br>https://www.youtube.com/watch?v=87UE2GC5db0<br><br>**„Habanera"** nga opera „Karmen" – Zh. Bizet<br>https://www.youtube.com/watch?v=K2snTkaD64U<br><br>**„Aria e Figaros"** nga opera „Seville Berberine" – Xh. Rosini<br>https://www.youtube.com/watch?v=7qHZkkgowdY | **Aktivitetet**<br><br>Njohja me veprat e skenës muzikore përmes prezantimit audio-vizual.<br><br>Diskutimi reth ngjashmërive dhe dallimevenë veprat e skenës muzikore.<br><br>Njohja me karakteristikat e operës dhe operetës.<br><br>Shikimi/dëgjimi i fragmenteve nga opera dhe opereta.<br><br>Njohja me karakteristikat e baletit.<br><br>Shikimi/dëgjimi i fragmenteve nga baleti.<br><br>Njohja me karakteristikat e muzikës.<br><br>Shikimi/dëgjimi i fragmenteve nga mjuzikëll. | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>1.1. numëron veprat e skenës muzikore;<br><br>1.2. definon rolet e dirigjentit, regjisorit, skenografit, kostumografit në veprat e skenës muzikore;<br><br>1.3. dallon karakteristikat në veprat e skenës muzikore;<br><br>1.4. krahason fragmente nga veprat e skenës muzikore të dëgjuara. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | **Fragment nga opereta:**<br>**„Kan-kan“** nga opereta „Orfeu në nëntokë“ – Zh. Ofenbah<br>https://www.youtube.com/watch?v=4Diu2N8TGKA<br><br>**Fragmenti nga baleti:**<br>**„Zhizel“** nga baleti „Zhizell“ – A. Adam<br>https://www.youtube.com/watch?v=3TLSrI_hXEw<br><br>**Fragment nga muzika:**<br>**„Mama mia! (Këtu jam përsëri)“** nga mjuzikëll **„Mama mia!“ –** B. Anderson<br>https://www.youtube.com/watch?v=DUjB9LTtzGg<br><br>**Nocionet:**<br>- opera<br>- opereta<br>- balet<br>- mjuzikëll<br>- dirigjent<br>- regjisor<br>- skenograf<br>- kostumograf | Dhënia e udhëzimeve dhe burimeve për kërkesë të pavarur e të dhënave për veprat skenike muzikore. | |
| **2.** | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>- diskuton për jetën dhe veprën e kompozitorit; | **Përpilimi përmbajtësor i operës nga kompozitorë të huaj:**<br>**„Aida“ -** Xh. Verdi<br>**Marshi triumfal (fragmente me kor, orkestër të skenës dhe balet)** | **Aktivitetet**<br><br>Njohja me jetën dhe veprën e Xhuzepe Verdi dhe operës „Aida“ (përmes prezantimit audio-vizual). | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>2.1. emëron kompozitorin dhe titullin e operës së dëgjuar |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | - vëren specifika të operës së dëgjuar (libreto-libretist; solistë; dirigjent të operës etj.);<br><br>- shpjegon për përmbajtjen e operës së dëgjuar. | https://www.youtube.com/watch?v=JXMdei-UTfw<br>**Arija e Radames „Celeste Aida“**<br>https://www.youtube.com/watch?v=XP1vp_G9mLc<br><br>**Finale – duet i Aida dhe Radames**<br>https://www.youtube.com/watch?v=Pp872-DIBQE<br><br>**Nocionet:**<br>-kompozitor (Xhuzepe Verdi)<br>-opera „Aida“<br>-libreto - libretist<br>-arija<br>-recitativ<br>-kor në operë<br>- akt | Përpilimi i përmbajtjes së shkurtë të operës.<br><br>Sqarimi për specifikat, karakteristikat përgatitja e operës.<br><br>Shikimi/dëgjimi nga opera (me sqarim të detyrueshëm të tekstit).<br><br>Dhënia e udhëzimeve dhe burimeve për kërkesë të pavarur e të dhënave për operat e kompozitorëve të huaj. | 2.2. përdor fjalët e tij/saj për jetën dhe veprën e kompozitorit dhe për përmbajtjen e shkurtë të operës së dëgjuar;<br><br>2.3. definon karakteristikat e fragmnteve të dëgjuara nga opera;<br><br>2.4. dallon rolet e kompozitorit, libretistit, solistit, kor, dirigjentit etj., në operën e dëgjuar. |
| **3.** | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>- diskuton për jetën dhe veprën e kompozitorit;<br><br>-vëren specifikat e operës së dëgjuar (libreto-libretist; solistë; dirigjent në operë etj.);<br><br>- shpjegon për përmbajtjen e operës së dëgjuar. | **Përpilimi përmbajtësor i operës nga kompozitor brenda vendit: „Despina dhe Mister Doks“ -** D. Buzharovski<br><br>https://www.youtube.com/watch?v=P6mzfDcO72E (pjesa1)<br>https://www.youtube.com/watch?v=oqqr4yOnHrg (pjesa 2)<br><br>**Nocionet:**<br>-kompozitor (Dimitrije Buzharovski)<br>-opera „Despina dhe Mister Doks’’ | **Aktivitetet**<br><br>Njohja me jetën dhe veprën e Dimitrije Buzharovski dhe opera ,,Despina dhe Mister Doks’’ (përmes prezantimit audio-vizual).<br><br>Përpilimi i përmbajtjes së shkurtë të operës.<br><br>Sqarimi i specifikave, karakteristikave, përgatitja e operës.<br><br>Shikimi/dëgjimi i fragmenteve të | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>3.1. emëron kompozitorin dhe titullin e operës së dëgjuar;<br><br>3.2. përdor fjalë të veta për jetën dhe veprën e kompozitorit dhe për përmbajtjen e shkurtë të operës së dëgjuar;<br><br>3.3. definon karakteristikat e fragmenteve të dëgjuara të operës;<br><br>3.4. dallon rolet e kompozitorit, |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | operës (me sqarim e detyrueshëm të tekstit).<br><br>Dhënia e udhëzimeve dhe burimeve për kërkim të pavarur e të dhënave për operat e kompozitorëve nga vendi. | libretistit; solistit; kor, dirigjent etj, në operën e dëgjuar. |
| **4.** | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>- diskuton për jetën dhe veprën e kompozitorit;<br><br>- vëren specifikat e operetës së dëgjuar (libreto-libretist; solistë; dirigjent në operetë etj.);<br><br>- shpjegon për përmbajtjen e operetës së dëgjuar. | **Përpilimi përmbajtësor i operetës: „Lakuriqi" - J. Shtraus**<br><br>**Uvertura**<br>https://www.youtube.com/watch?v=otMOXwFdxN8<br><br>**Dueti ndërmjet Rozalinda dhe Ajzenshtajn**<br>https://www.youtube.com/watch?v=KxWrivXswg4<br><br><br>**Valsi**<br>https://www.youtube.com/watch?v=otMOXwFdxN8<br><br>**Arija e Adel**<br>https://www.youtube.com/watch?v=npLZNoRoH2M<br><br>**Çardash**<br>https://www.youtube.com/watch?v=PPFNCROfRJk<br><br>**Nocionet:** | **Aktivitetet**<br><br>Njohja me jetën dhe veprën e Johan Shtraus dhe opereta „Lakuriqi" (përmes prezantimit audio-vizual).<br><br>Përpilimi i përmbajtjes së shkurtë të operetës.<br><br>Sqarimi i specifikave, karakteristikave, përgatitjes së operetës.<br><br>Shikimi/dëgjimi i fragmenteve nga opereta (me sqarimin e detyrueshëm të tekstit).<br><br>Dhënia e udhëzimeve dhe burimeve për kërkim të pavarur të të dhënave për operetat. | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>4.1. emëron kompozitorin dhe titullin e operetës së dëgjuar;<br><br>4.2. përdor fjalë personale për jetën dhe veprën e kompozitorit dhe për përmbajtjen e shkurtë të operetës së dëgjuar;<br><br>4.3. definon karakteristikat e fragmenteve të dëgjuara nga opereta;<br><br>4.4. dallon rolet e kompozitorit, libretistit, solistëve; korit; dirigjentit etj., në operetën e dëgjuar. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | - kompozitor (Johan Shtraus)<br>- opereta „Lakuriqi“ | | |
| **5.** | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>- diskuton për jetën dhe veprën e kompozitorit;<br><br>- percepton specifikat e operës së dëgjuar (libreto-libretist; balerinë/baletan; koreograf; dirigjent në balet;<br>- shpjegon për përmbajtjen e baletit. | **Përpilimi përmbajtësor e baletit nga kompozitorët e huaj: „Liqeni i mjellmave“ –**<br>**P. I. Çajkovski**<br><br>**Tema kryesore**<br>https://www.youtube.com/watch?v=jjDYW46PjA8<br><br>**Valsi**<br>https://www.youtube.com/watch?v=e2pwKjbw6Mk<br><br>**Valsi i mjellmave**<br>https://www.youtube.com/watch?v=aLMPVBJv_Ts<br><br>**Solo e Odetës**<br>https://www.youtube.com/watch?v=KAfPbrhGKcU<br><br>**Vallëzimi i mjellmave të vogla**<br>https://www.youtube.com/watch?v=Xd2nTXsivHs<br><br>**Nocionet:**<br>- kompozitor (P. I. Çajkovski)<br>- balet „Liqeni i mjellmave“<br>- balerinë<br>- prima balerinë<br>- baletan<br>- koreograf | **Aktivitetet**<br><br>Njohja me jetën dhe veprën e Petar Iliç Çajkovski dhe baletit ,,Liqeni i mjellmave’’ (përmes prezantimit audio-vizual).<br><br>Përpilimi i përmbajtjes së shkurtë të baletit.<br><br>Sqarimi i specifikave, karakteristikave, përgatitjes së baletit.<br><br>Shikimi/dëgjimi i fragmenteve të baletit.<br><br>Dhënia e udhëzimeve dhe burimeve për kërkimin e pavarur e të dhënave për baletët e kompozitorëve të huaj. | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>5.1. emëron kompozitorin dhe titullin e baletit;<br><br>5.2. përdor fjalë personale për jetën dhe veprën e kompozitorit dhe për përmbajtjen e shkurtër të baletit;<br><br>5.3. definon karakteristikat e fragmenteve të baletit;<br><br>5.4. dallon rolin e kompozitorit; koreografit; balerinës; baletanit; dirigjentit në balet etj. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **6.** | **Nxënësi/nxënësja:**<br>-njeh titullin nga baleti i dëgjuar dhe diskuton për jetën dhe veprën e kompozitorit nga vendi;<br><br>-vërenë specifikat e baletit (libreto-libretist; balerinë/baletan; dirigjent në operën e baletit; regjisor; koreograf; kostumograf; korepetitor etj.), dhe shpjegon për përmbajtjen e baletit të dëgjuar nga kompozitori i vendit; | **Përpilimi përmbajtësor i baletit nga kompozitorët e vendit**<br><br>**„Labin dhe Dojrana“** të baletit „Labin dhe Dojrana“ – T. Prokopiev<br><br>https://www.youtube.com/watch?v=J33smJpBEIY<br><br>**Nocionet:**<br>-kompozitor (Trajko Prokopiev)<br>-belet „Laabin dhe Dojrana“ | **Aktivitetet**<br><br>Njohja e jetës dhe veprës të Trajko Prokopiev dhe baletit ,,Labin dhe Dojrana’’ (përmes prezantimit audio vizual).<br><br>Përpilimi i përmbajtjes së shkurtë të baletit.<br><br>Sqarimi për specifikat, karakteristikat, përgatitja e baletit.<br>Shikimi/dëgjimi i fragmenteve nga baleti.<br>Dhënia e udhëzimeve dhe burimeve për kërkimin e pavarur e të dhënave për baletët nga kompozitorët e vendit. | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>6.1. emëron kompozitorin dhe titullin e baletit;<br><br>6.2. përdorë fjalë personale për jetën dhe veprën e kompozitorit dhe për përmbajtjen e shkurtë të baletit;<br><br>6.3. definon karakteristikat e fragmentit nga baleti;<br><br>6.4. dallon llojet e kompozitorit; koreografit; balerinës; baletanit; dirigjentit në balet etj. |
| **7.** | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>-njeh titujt e mjuzikëll të dëgjuar;<br><br>- njeh titullin nga dëgjimi i mjuzikëll dhe shpjegon karakteristikat e një vepre në skenë muzikore - mjuzikëll;<br><br>-vëren specifikat e mjuzikëll dhe shpjegon për përmbajtjen e muzikës së dëgjuar. | **Mjuzikëll**<br><br>**Skena e sallës për ballo nga** muzika e filmit **„E bukura dhe bisha“** – A. Menken<br>https://www.youtube.com/watch?v=Z-VeQqV-KTI<br>Nga filmi sipas muzikës me të njëjtin emër ,,Tingujt e muzikës" **„Sounds of Music“ –** R. Roxhers (Richard Rodgers):<br>**„Do, re, mi“**<br>https://www.youtube.com/watch?v=drnBMAEA3AM<br>**„So Long Farewell“**<br>https://www.youtube.com/watch?v=Qy9_lfjQopU | **Aktivitetet**<br><br>- Njohja me mjuzikëll si vepër skenike-muzikore (përmes prezantimit audio vizual).<br><br>Sqarimi për specifikat, karakteristikat, përgatija e mjuzikëll**.**<br><br>Shikimi/dëgjimi i fragmenteve nga mjuzikëll.<br><br>Përpilimi i përmbajtjes së shkurtër nga mjuzikëll i dëgjuar.<br><br>Dhënia e udhëzimeve dhe burimeve për kërkimin e pavarur e të dhënave për | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>7.1. emëron tituj nga mdëgjimi i mjuzikëll;<br><br>7.2. përdorë fjalët personale për përmbajtjen e shkurtë nga dëgjimi i mjuzikëll;<br><br>7.2. definon karakteristikat e fragmenteve të mjuzikëll;<br><br>7.4. dallon rolin e: kompozitorit, libretistit, solistit, koreografit, valltarëve, dirigjentt, regjisorit etj., në mjuzikëll. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | **Nocionet:**<br>-mjuzikëll<br>-mjuzikëll filmi<br>-mjuzikëll teatri | mjuzikëll. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **8.** | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>- përdor nocione që ndërlidhen me muzikën filmike;<br><br>- dëgjon dhe dallon fragmente nga filma të ndryshëm. | **Muzika filmike nga autorë të huaj dhe nga vendi**<br><br>**Tema kryesore nga filmi** „Indiana Xhons“ – Xh. Vilijams<br>https://www.youtube.com/watch?v=ntXJJwEk1NA<br><br>**„Море сокол пие“** nga filmi „Pjesa e tretë“ – К. Xhajkovski<br>https://www.youtube.com/watch?v=OTFMdtgDtIE<br><br>**Nocionet:**<br>-Muzika filmike | **Aktivitetet**<br><br>Njohja me muzikën filmike dhe sqarimi i zhvillimit të saj<br><br>Të shikuarit/dëgjimi i dy ose më tepër fragmenteve nga muzika filmike, e ndryshme për nga karakteri dhe përmbajtja.<br><br>Përpilimi i përmbajtjes së shkurtër të tekstit në film. | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>8.1. numëron tema të njohura muzikore nga filmat;<br><br>8.2. sqaron njohuri të përgjithshme për muzikën filmike;<br><br>8.3. vlerëson tema të ndryshme muzikore sipas karakterit (mallëngjyese, të dashurisë, humoristike etj.).<br><br>8.4. krahason fragmentet muzikore nga muzika filmike me fragmente nga zhanret tjera (ngjashmëritë dhe dallimet). |
| **9.** | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>- përdor nocione të ndërlidhura me zhanret xhaz dhe bluz; | **Njohja me zhanret xhaz dhe bluz**<br><br>**Bluz:**<br>**„Ndjehem mirë“ plotëson Nina Simon** | **Aktivitete**<br><br>Njohja me karakteristikat e zhanreve xhaz dhe bluz. | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>9.1. emëron karakteristikat kryesore të zhanreve xhaz dhe bluz; |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | - dëgjon dhe dallon fragmente nga xhaz dhe bluz. | https://www.youtube.com/watch?v=Ff-0pHwyQ1g<br><br>**„Secili ka nevojë për dikën“ plotësojnë Bluz Bradrs**<br>https://www.youtube.com/watch?v=tUgavzoYKZI<br><br>**Xhaz:**<br>**„Колку убав свет (Sa botë e bukur)“** realizon Luis Armstrong<br>https://www.youtube.com/watch?v=A3yCcXgbKrE<br><br>**„Треска (Ethet)“** realizon Pegi Li<br>https://www.youtube.com/watch?v=JGb5IweiYG8<br><br>**Nocionet:**<br>-muzika xhaz<br>-muzika bluz | - Dëgjimi i njëpasnjëshëm i shembujve karaktersitik të zhanreve xhaz dhe bluz dhe vrojtimi i karakteristikave të tij muzikore.<br><br>- Diskutimi për elementet e shprehura muzikore në shembujt për dëgjim (tempo, dinamika, lloji i interpretimit, karakteri etj). | 9.2. sqaron për karakteristikat themelore të zhanreve xhaz dhe bluz;<br><br>9.3. bën dallim ndërmjet vlerave të zhanreve xhaz dhe bluz;<br><br>9.4 dallon zhanret xhaz dhe bluz nga zhanret tjera (ngjashmëritë dhe dallimet). |
| **10.** | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>- përdor nocione të ndërlidhura me zhanret RnB, hip – hop dhe rap;<br><br>- dëgjon dhe dallon fragmente nga RnB, hip – hop dhe rap. | **Njohja me zhanret RnB, hip – hop dhe rap**<br><br>**RnB**<br>**„Halo“** - Beyoncé<br>**„Oreol“** realizon Bionce<br>https://www.youtube.com/watch?v=bnVUHWCynig<br><br>**„Human“** - Rag'n'Bone Man<br>**„Човек“** realizon Рег ен Боун | **Aktivitetet**<br><br>-Njohja me karakteristikat e zhanreve RnB, hip – hop dhe rap.<br><br>-Dëgjimi i njëpasnjëshëm i shembujve karaktersitik nga zhanret RnB, hip – hop dhe rap dhe vrojtimi i karakterstikave të veta muzikore. | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>10.1. mban mend karaktersitika themelore të zhanreve RnB, hip – hop dhe rap;<br><br>10.2. sqaron për zhanret RnB, hip – hop dhe rap;<br><br>10.3.bën dallim ndërmjet vlerave të zhanreve RnB, hip – hop dhe rap; |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | https://www.youtube.com/watch?v=L3wKzyIN1yk<br><br>**Hip-hop dhe rap**<br>**„Changes“** – 2pac<br>**„Ndrysho“** realizon Ty përsëri<br>https://www.youtube.com/watch?v=ghQiosjuaic<br><br>„**Црнила ремикс**“ (dramë e llojit rap) regjisor Jordan Simonov, muzika Darko Dimitrievski dhe Pavle Dimkovski (video fragment)<br>https://www.youtube.com/watch?v=bJnGd25ZNU4<br><br>**Nocionet:**<br>-muzikë RnB<br>-muzikë Hip - hop<br>-muzikë rap | -Diskutimi i elementeve shprehëse muzikore në shembujt e dëgjimit të (tempos, dinamikës, llojit të interpretimit, karakterit).<br><br>Bisedë për interpretuesit e njohur të RnB, Хип-хоп dhe rap. | 10.4. krahason fragmente muzikore nga zhanret RnB, hip – hip dhe rap me fragmente nga zhanret tjera (ngjashmëritë dhe dallimet). |
| **11.** | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>- përdor nocione të ndërlidhura me zhanret Rock and roll dhe POP;<br><br>- dëgjon dhe dallon fragmente nga Rock and roll dhe POP. | **Njohja me zhanret Rock and roll dhe POP**<br><br>**Rock and roll**<br>**„Love me do“** – The Beatles**/„Сакај ме“** interpretojnë Bitllsat<br>https://www.youtube.com/watch?...<br><br>**„Natural“**-Imagine Dragons**/„Natyrore“** realizojnë<br>https://www.youtube.com/watch | **Aktivitetet**<br><br>Njohja me karakteristikat e zhanreve të Rock and roll dhe POP.<br><br>-Dëgjim i vazhdueshëm i shembujve karaktersitik nga zhanret Rock and roll dhe POP dhe të vërejturit e karakteristikave të tyre muzikore.<br><br>-Diskutim për elementet shprehëse muzikore në shembujt për dëgjim | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>11.1. mban mend karakteristika të zhanrit Rock and roll dhe POP;<br><br>11.2. sqaron për zhanret Rock and roll dhe POP;<br><br>11.3. bën dallim ndërmjet vlerave të zhanreve Rock and roll dhe POP;<br><br>11.4. krahason fragmentet muzikore të zhanreve Rock and roll dhe POP |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | ?v=0I647GU3Jsc&list=PL3oW2tjiIxvQWubWyTI8PF80gV6Kpk6Rr&index=6<br><br>**POP**<br>**„The Flood“** - Take That **/„Vërshimi“ plotësojnë** Take That<br>https://www.youtube.com/watch?v=aCHg5r6rFoI<br><br>**„Tornado“/„Торнадо“** – група/grupi Elita 5/Елита 5<br>https://www.youtube.com/watch?v=JyBpPo0LUEw<br><br>**„New Rules“/„Rregulla të reja“ Dua llipa**<br>https://www.youtube.com/watch?v=k2qgadSvNyU<br><br>**Nocionet:**<br>-Rock and roll muzika<br>-Pop muzika | (tempo, dinamika, lloji i interpretimit, karakteri).<br><br>Bisedë për interpretuesit e njohur të Rock and roll dhe POP.<br><br>**Rekomandim:** për prezantimin e shembujve muzikor duhet përdorur inçizimi audio – vizual (nëse lejojnë kushtet në shkollë)<br><br>**Metodat:**<br>• monolog;<br>• dialog;<br>• demonstruese;<br>• puna praktike. | me fragmentet e zhanreve tjera (ngjashmëritë dhe dallimet); |

| TEMA 3. SHKRIM – LEXIMI MUZIKOR ( 6 orë ) | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr. rend or** | **Rezultatet e mësimit** | **Përmbajtjet dhe nocionet** | **Aktivitetet dhe metodat** | **Standardet e vlerësimit** |
| **1.** | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>- sqaron dhe vëren shkallën F – dur me elementet e veta;<br><br>- këndon/ekzekuton shkallën F - dur me elementet e veta. | **Shkalla F-dur me elementet e saj (emrat e toneve – solmizimi dhe alfabeti muzikor, grada, shkalla – e plotë dhe gjysmë shkalla, parashenja b, tetrakordi)** | **Aktiviteti**<br><br>Të shkruarit, këndimi, ekzekutimi i shkallës F – dur, me elementet e veta (emrat e toneve – solmizimi dhe alfabeti muzikor, grada, shkalla – e plotë dhe gjysmë shkalla, parashenja b, tetrakordi).<br><br>Dëgjimi, këndimi, interpretimi i ushtrimeve në shkalln F - dur. | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>1.1. numëron elemente të shkallës F-dur<br><br>1.2. shënon shkallën F-dur me elementet e veta<br><br>1.3. zbaton bemolin, përkatësisht parashenjën b në shkallën F - dur<br><br>1.4. këndon/interpreton shkallën F-dur |
| **2.** | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>- dallon dhe sqaron shkallën d-moll llojin natyror, llojin harmonik dhe llojin melodik me elementet e veta;<br><br>- këndon/interpreton shkallën d-moll llojin natyror, llojin harmonik dhe llojin melodik me elementet e veta. | **Shkalla d-moll lloji natyror, lloji harmonik dhe lloji melodik me elementet e veta (emrat e toneve – solmizimi dhe alfabeti muzikor, grada, shkalla – e plota, gjysmë shkalla dhe shkalla e gjysmë, parashenja b, tetrakordi)** | **Aktivitetet:**<br><br>Të shkruarit, këndimi, interpretimi dhe njohja e shkallës d-moll lloji natyror, lloji harmonik dhe lloji melodik me elementet e veta (emrat e toneve – solmizimi dhe alfabeti muzikor, grada, lloji natyror, lloji harmonik dhe lloji melodik me elementet e veta (emrat e toneve – solmizimi dhe alfabeti muzikor, grada, shkalla – e plota, gjysmë shkalla dhe shkalla dhe e plotë, parashenja b, tetrakordi). | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>2.1. numëron elementet e shkallës d – moll natyrore, harmonike dhe melodike<br><br>2.2. shënon shkallën d-moll natyrore, harmonike dhe llojin melodik me elementet e veta<br><br>2.3. demonstron me këndim/ekzekutim shkallën d-moll natyrore, harmonike dhe llojin melodik |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | Krahasimi (vizualisht dhe përmes dëgjimit) të shkallës d - moll natyrore, harmonike dhe lloji natyror përmes:<br>- të shkruarit dhe krahasimi i llojeve të shkallës;<br>- dëgjimi i zëshmërisë së secilit lloj të shkallës dhe krahasimi i saj.<br>- njohja e llojeve të d – moll sipas përfshierjes së diezit, kryesisht toni cis dhe bekuari, kryesisht toni h në ushtrimet melodike dhe këngët me vlera të ndryshme të notave dhe pauzave në taktet e masës së thjeshtë dhe masës së përzier 5/8, 7/8 dhe 9/8.<br><br>**Mbani mend:** mësimdhënësi është i lirë të rregullojë numrin e orëve për mësimin e tre lloje të d – moll sipas nevojave dhe mundësive të nxënësve, përderisa standardet e vlerësimit kanë të bëjnë për të tre llojet e integruara. | 2.4. krahason llojin d-moll natyror, harmonik dhe melodik vizualisht /me dëgjim |
| **3.** | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>- sqaron dhe shkruan bemol;<br><br>- diskuton për rolin e bemolit në shkallët F – dur dhe d - moll. | **Bemoli** | **Aktivitetet**<br>Të shkruarit dhe njohja e bemol në ushtrimet melodike dhe këngët në F – dur dhe në d – moll me vlera të ndryshme notale dhe pauza si dhe shenjat e vazhdimit të vlerës së notave në taktet e thjeshta dhe të përziera në taktet 5/8, 7/8 dhe 9/8. | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>3.1.identifikon vizualisht bemol;<br><br>3.2.shkruan drejt (bemol) në pentagram (në vijë dhe në zbrazëtirë);<br><br>3.3. përdorim i bemolit për ndërtimin e shkallës F-dur dhe d-moll; |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | 3.4. dallon shkallën F-dur nga d-moll në ushtrimet dhe këngët melodike; |
| **4.** | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>- vëren sinkopën dhe sqaron për përcjelljen e theksit të kohës së keqe (një pjesë e kohës);<br><br>- këndon/ekzekuton sinkopën tetëshe-katërshe – tetëshe me taktimin e ushtrimeve melodike. | **Sinkopa** | **Aktivitetet:**<br><br>„Matematika muzikore“ (mbledhja – zbritja e vlerave notale, prezenatimi i tyre përmes thyesës etj).<br><br>Shqiptimi i ushtrimeve ritmike me sinkopën me taktim në taktet 2/4, 3/4, 4/4.<br><br>Këndimi dhe ekzekutimi i ushtrimeve melodike me sinkopën përmes dëgjimit dhe përmes notave në taktet 2/4, 3/4 dhe taktet 4/4. | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>4.1. njeh sinkopën<br><br>4.2. shënon sinkopën<br><br>4.3.përdor sinkopën në ushtrimet ritmike dhe melodike në taktet 2/4, 3/4 dhe 4/4<br><br>4.4. interpreton sinkopën me taktim në ushtrimet ritmike në taktet 2/4, 3/4 dhe 4/4 |
| **5.** | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>- vëren vizualisht taktin e përzier 9/8 dhe përcakton takte, pjesë takti (goditje) me taktim;<br><br>-këndon/ekzekuton ushtrime melodike dhe këngë në taktin 9/8 sipas notave. | **Takti i përzier 9/8** | **Aktivitetet**<br>Njeh taktin 9/8 përmes dëgjimit dhe përmes këndimit të ushtrimeve melodike dhe këngëve (valle etj.).<br><br>Perceptimi i ndarjes së ndryshme të taktit 9/8.<br><br>Sqarimi i zgjatjes së pjesëve të taktit.<br>Vërejtja e pulsimeve të ndryshme të taktit (përmes numërimit, | **Nxënësi/nxënësja:**<br>5.1. njeh taktin 9/8 në shembujt e notave<br><br>5.2. definon për ndarjen e taktit 9/8<br><br>5.3. drejtë i takton nëntë tetëshet në taktin 9/8<br><br>5.4. interpreton ushtrimet ritmike në taktin 9/8 sipas notave |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | <br><br><br><br><br><br><br><br><br>**Nocionet:**<br>- shkalla F-dur<br>- shkalla d-moll natyrore, lloji harmonik dhe melodik<br>- bemol<br>- sinkopa<br>- takti i përzier 9/8 | shqiptimit të tekstit, lëvizjet – kërcitjet, trokitjet etj).<br><br>Të shkruarit e sqarimit të taktit 9/8.<br><br>Interpretimi i këngëve dhe ushtrimeve të lehta ritmike dhe melodike në taktin 9/8 sipas notave.<br><br>**Metodat:**<br>• monolog;<br>• dialog ose metoda e bisedës;<br>• demonstruese;<br>• puna praktike. | |

| | **TEMA 4. KRIJIMTARIA POPULLORE MUZIKORE – Traditat dhe zakonet (4 orë)** | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr. rend or** | **Rezultatet e mësimit** | **Përmbajtja dhe nocionet** | **Aktivitetet dhe metodat** | **Standardet e vlerësimit** |
| **1.** | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>- dallon traditat dhe zakonet e popullit dhe popujve të cilët jetojnë në vendin | <br>**Tradita dhe zakonet e popullit të vetë dhe popujve të cilët jetojnë në vendin tonë** | **Aktivitetet**<br><br>Definimi i nocioneve tradita dhe zakonet. | **Nxënësi/nxënësja**:<br><br>1.1. numëron zakone të popullit të vetë dhe popujve të cilët jetojnë në vendin tonë; |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | tonë;<br><br>- krahason zakonet e popullit të vetë me zakonet e popujve të cilët jetojnë në vendin tonë dhe kërkon këngë të ndërlidhura me zakonet. | **Nocionet:**<br>-tradita<br>-zakonet | Sqarimi i zakoneve më karakteristike të popujve të cilët jetojnë në vendin tonë.<br><br>Diskutimi i këngëve me përmbajtje rituale.<br><br>Dhënia e udhëzimeve dhe burimet për kërkimin e pavarur të të dhënave për traditën dhe zakonet. | 1.2. sqaron për zakonet e popullit të vetë dhe popujve të cilët jetojnë në vendin tonë;<br><br>1.3. demonstron një pjesë të këngës për zakon të caktuar;<br><br>1.4. dallon këngë sipas dëgjimit të ndërlidhura me zakonet e popujve të cilët jetojnë në vendin tonë. |
| **2.** | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>- emëron këngë të ndërlidhura me dasmat;<br><br>- përshkruan ritin e dasmës tradicionale të popullit të vetë dhe popujve të cilët jetojnë në vendin tonë;<br><br>- vëren këngë, valle dhe vallëzime në ciklin e dasmës. | **Cikli i dasmës** | **Aktivitetet**<br><br>Definimi i nocionit cikli i dasmës (dasëm tradicionale).<br><br>Sqarimi i zakoneve më karakteristike të ciklit të dasmës (dasma tradicionale) e popullit të vetë të cilët jetojnë në vendin tonë.<br><br>Diksutim për këngët, vallet dhe vallëzimet e rajonit të vetë me përmbajtje nga cikli i dasmës (dasma tradicionale) e popullit të vetë dhe popujve të cilët jetojnë në vendin tonë.<br><br>Dhënia e udhëzimeve dhe burimet për kërkimin e pavarur të të dhënave për traditën dhe zakonet. | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>2.1.numëron këngë të ndërlidhura për dasmën tradicionale<br><br>2.2.sqaron për ritet e dasmës tradicionale të popullit të vetë dhe popujve të cilët jetojnë në vendin tonë<br><br>2.3. krahason zakone të ndërlidhura me dasmën tradicionale të popujve të cilët jetojnë në vendin tonë<br><br>2.4. dallon këngë, valle dhe vallëzime me dasëm tradicionale |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | **Nocion:**<br>-cikli i dasmës | **Mbani mend!** Rekomandohet të përdoren materiale audio – vizuale për **ciklin e dasmës** (dasma tradicionale) nga vendi i vetë. | |
| **3.** | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>- njeh veshjet e popullit të vetë;<br><br>- sqaron për veshjet e popujve të cilët jetojnë në vendin tonë;<br><br>-krahason veshjet e popujve të cilët jetojnë në vendin tonë. | **Veshjet popullore**<br><br>**Nocionet:**<br>-Veshjet popullore | **Aktivitetet**<br><br>Sqarimi i pjesëve më karakteristike të veshjeve popullore të popullit të vetë dhe të popujve të cilët jetojnë në vendin tonë.<br><br>Diskutim për specifikat e veshjeve popullore.<br><br>Dhënia e udhëzimeve për kërkimin e veshjeve popullore për popullin e vetë dhe të popujve të cilët jetojnë në vendin tonë. | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>3.1. thekson veshjet e popullit të vetë;<br><br>3.2. emëron veshjet e popujve të cilët jetojnë në vendin tonë;<br><br>3.3. dallon veshje të popujve të cilët jetojnë në vendin tonë;<br><br>3.4. përpilon album të veshjeve të popullit të vetë dhe të popujve të cilët jetojnë në vendin tonë; |
| **4.** | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>-dallon këngë të përpunuara popullore;<br><br>-përshkruan karakteristika (instrument të përfshirë, mënyrën e këndimit, teknologjinë e shfrytëzuar etj) të përpilimit të këngëve popullore;<br><br>- krahason këngë popullore burimore sipas dëgjimit. | **Muzika popullore në zhanret muzikore moderne** | **Aktivitetet**<br><br>Demonstrimi i shembujve të ndryshëm të muzikës moderne me elemente popullore.<br><br>Diskutimi për elementet popullore të përpunuara në këngët moderne.<br>Krahasimi i interpretimeve të këngës popullore zgjedhore me përpunim të këngës së njëjtë.<br><br>Dhënia e udhëzimeve dhe burimet për | **Nxënësi/nxënësja:**<br><br>4.1. numëron këngë të përpunuara popullore;<br>4.2. definon karakteristika (instrumente të përfshira, mënyrën e këndimit, teknologjinë e shfrytëzuar etj.) të përpunimeve të këngëve popullore;<br>4.3. dallon këngën popullore burimore nga kënga e përpunuar sipas dëgjimit; |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | kërkimin e pavarur të të dhënave për këngët me motive popullore.<br><br>**Metodat:**<br>• monolog;<br>• dialog ose metoda e bisedës;<br>• demonstruese;<br>• puna praktike. | 4.4. ndërlidh elementet e përbashkëta nga kënga burimore popullore; |

**SHTOJCË**

**LISTË E KËNDIMIT TË KËNGËVE NË KLASËN IX**

| Nr. rendor | KËNGË PËRMES DËGJIMIT | KËNGË PËRMES NOTAVE |
|---|---|---|
| | **GJUHË MAQEDONASE** | |
| **1.** | **„Момиче мало ѓаволо“ - народна**<br>**,,Djaloshi i vogël djall’’ - popullore** | **„Либе ако дојдеш“ – народна**<br>**,,Libe nëse vjen’’ - popullore** |
| **2.** | **„Пролет“- Т. Таневски**<br>**,,Pranvera’’ – T. Tanevski** | **„Заспало моме“ - народна**<br>**,,Vashëza e fjetur’’ - popullore** |
| | **GJUHË SHQIPE** | |
| | **KËNGË PËRMES DËGJIMIT** | **KËNGË PËRMES NOTAVE** |
| **1.** | **„Dy lule të bardha”/„Две бели цвеќиња“** | **„Gëzimi“/ „Радост“ - L. V Bethowen, Simfonia IX** |
| **2.** | **„Tumankuqe” - popullore“/ „Црвенокоса“ -** народна<br>https://www.youtube.com/watch?v=QA5Hgg8QLRw | **„Pranvera“ E Stafai/„Пролет“ - Е. Стафаи** |

| | | |
|---|---|---|
| | **GJUHË TURKE** | |
| | **KËNGË PËRMES DËGJIMIT** | **KËNGË PËRMES NOTAVE** |
| **1.** | **„Manastırın  Ortasında” /„Në qendër të Manastirit“** | **„Dere Geliyor“/„Gjen burimin“ 9/8** |
| **2.** | **„Yağmur yağar taş üstüne“/„Mbi një vesë guri“** | **„Habu Diyar“/ „Vendlindja“** |
| | **GJUHË ROME** | |
| | **KËNGË PËRMES DËGJIMIT** | **KËNGË PËRMES NOTAVE** |
| **1.** | **,,Alo dive romano‘‘ / „Erdhi dita e romëve“** https://www.youtube.com/watch?v=NNEc6f8WfKY | **„Nane tsokha‘‘/,,Pa këpucë, pa këmishë“** https://www.youtube.com/watch?v=_yer-9MCQG0 |
| | **GJUHË SERBE** | |
| | **KËNGË PËRMES DËGJIMIT** | **KËNGË PËRMES NOTAVE** |
| **1.** | **„Певам дању, певам ноћу“/**,,Këndoj ditën, këndoj natën’’-К.Kovaç | **„Пред Сенкином куќом“/**„Para shtëpisë së Senka“-këngë e vjetër qytetare |
| | **GJUHË VLLEHE** | |
| | **KËNGË PËRMES DËGJIMIT** | **KËNGË PËRMES NOTAVE** |
| **1.** | **„Ti inatea a cuscārljei“/„За инает на сваќата“** | **„Ah, tsi nj-u dor“/ „Ах, што е оваа болка“** |
| | **GJUHË BOSHNJAKE** | |
| | **KËNGË PËRMES DËGJIMIT** | **KËNGË PËRMES NOTAVE** |
| **1.** | **„Blejedi mesec“** | **„Samo pjesma, samo smijeh“** |
| | **DËGJIM I MUZIKËS**<br>**VEPRA MUZIKORE - SKENIKE** | |

| | |
|---|---|
| **1.** | **OPERA** |
| | -**„La Dona e mobile“** /**„Жената е каприциозна“** од операта „Риголето“ - Џ. Верди<br>https://www.youtube.com/watch?v=8A3zetSuYRg |
| | -**„Una furtiva lagrima“ / „Една таинствена солза“** од операта „Еликсир на љубовта“ - Г. Доницети<br>https://www.youtube.com/watch?v=Hrh5oiy5kR8 |
| | -**,,На уранку’’/„В зори“** - С. Бинички<br>https://www.youtube.com/watch?v=9SD6m9ZzJo0&t=21s |
| | -**„Хорот на Евреите“** од операта ,,Набуко“ - Џ.Верди<br>https://www.youtube.com/watch?v=2F4G5H_TTvU |
| | -**„Deh vieni, non tardar“ / „О, дојди , не доцни“** од операта „Свадбата на Фигаро“ – В. А. Моцарт (речитатив)<br>https://www.youtube.com/watch?v=eRxKgrOOQcI |
| | -**„Mrika“/„Мрика“ –** P. Jakova/П. Јакова<br>https://www.youtube.com/watch?v=r7irdE4GQ_g |
| | -**„Özsoy operası’’/„Опера Озсој“** – A. A. Saygun/А. А. Сајгун, увертира/uvertür<br>https://www.youtube.com/watch?v=JPDSWe2R9dU |
| **2.** | **OPERETA** |
| | -**„Песната на Вилја“** од „Веселата вдовица“ – Ф. Лехар<br>https://www.youtube.com/watch?v=l_e8g4LhAOA |
| | -**,,Коштана’’**- П.Коњовић<br>https://www.youtube.com/watch?v=7MDXdQoH4Zs |
| | -**„Бајадера“** - И. Калман<br>https://www.youtube.com/watch?v=jZUK6mNtFFM |
| **3.** | **BALETI** |
| | -**„Адаџо на Цезар и Клеопатра“** од балетот „Клеопатра“ – Н. Голдберг<br>https://www.youtube.com/watch?v=vRmCXwVEd34<br>-**„Halili dhe Hajria" baleti /**балет **„Халил и Хајрија“**<br>https://www.youtube.com/watch?v=VSmqDFGDUR0 |
| | -**„Финале“** од балетот „Дон Кихот“ – Л. Минкус<br>https://www.youtube.com/watch?v=5fKxzQ8ARTQ |

| | |
|---|---|
| | -**,,Грлица''** од балетот „Охридска легенда" – С. Христиќ<br>https://www.youtube.com/watch?v=3GJE4_hiwTI |
| | -**„Оревокршачка"** - П. И. Чајковски |
| | -**„Охридската робинка Ташула"** – С. Стојков |
| **4.** | **MJUZIKLL** |
| | -**„Do You Hear The People Sing" / „Ги слушаш ли луѓето како пеат"** од мјузиклот **„Клетници"** –К. Шонберг<br>https://www.youtube.com/watch?v=gMYNfQlf1H8 |
| | -Главна тема од мјузиклот **„Фантомот од операта"** – В. Л. Вебер<br>https://www.youtube.com/watch?v=-JaeBxYCI9k&list=PLfcG34xYVtm7QWsqXg5oSopfDKuMJnwKV&index=17 |
| | -„**Мама миа, Еве ме пак"** - Б. Андерсон<br>https://www.youtube.com/watch?v=DUjB9LTtzGg |
| **5.** | **Muzika filmike nga autorë të vendit dhe të huaj** |
| | **-Главна тема од филмот „Војна на Ѕвездите"**<br>https://www.youtube.com/watch?v=_D0ZQPqeJkk |
| | **-Тема од филмот „Фросина" – Т. Прокопиев**<br>https://www.youtube.com/watch?v=zIvrnr_Ww2g |
| | **-„Амелија" од филмот „Амелија Пулен"**<br>https://www.youtube.com/watch?v=VwotqWGrLCo |
| | **-Главна тема од „Војна на Ѕвездите"**<br>https://www.youtube.com/watch?v=_D0ZQPqeJkk |
| | **-Тема од филмот „Шиндлерова листа„**<br>https://www.youtube.com/watch?v=VorGotjeLjM |
| **6.** | **Zhanret xhaz dhe bluz** |
| | -**„Please Love Me"** - B.B. King<br>**„Те молам сакај ме"** исполнува Б.Б. Кинг<br>https://www.youtube.com/watch?v=q-fQd3uoPjQ |

| | |
|---|---|
| | -**„Take Five“** – D. Brubeck<br>**„Дај си рака“** исполнува Д. Брубек<br>https://www.youtube.com/watch?v=vmDDOFXSgAs |
| **7.** | **Zhanret RnB, hip – hop dhe rap** |
| **7.1.** | **RnB** |
| | -**„Diamonds“/„Дијаманти“** - Rihanna/ исполнува Риана<br>https://www.youtube.com/watch?v=lWA2pjMjpBs<br>-**„Your Song“/„Твоја песна“ –** R. Ora / исполнува Р. Ора<br>https://www.youtube.com/watch?v=i95Nlb7kiPo<br>**-„Bon-bon“/„Може може“, E. Istrefi /Е. Истрефи**<br>https://www.youtube.com/watch?v=cedoBlUvBlI |
| **7.2.** | **Hip - hop** |
| | -**„Jump“**- K. Kross **/ „Скокај“** исполнува К. Крос<br>**https://www.youtube.com/watch?v=010KyIQjkTk** |
| **7.3.** | **Рап** |
| | -**„Prince Igor“** - Warren G **/„Принц Игор“** исполнува В. Џи (Тема од операта „Кнез Игор“ на Бородин)<br>**https://www.youtube.com/watch?v=N__bE-IU4zQ** |
| **8.** | **Zhanret Rock and roll dhe POP** |
| **8.1.** | **Rock and roll** |
| | -**„The Final Countdown“** – Europe/**„Последно одбројување“** исполнува Европа<br>https://www.youtube.com/watch?v=9jK-NcRmVcw&index=11&list=RDQMoRQgXn2bmgw |
| | -**„Сакај ме“** исполнуваат Битлси<br>https://www.youtube.com/watch?v=h-2QtmluZQU&index=33&list=PL9-cZf_sidpnrpRDlmAiLJaFtzHpD7aFY |
| **8.2.** | **POP** |
| | -**„Angels“** - Robbie Williams/**„Ангели“** исполнува Робин Вилијамс<br>https://www.youtube.com/watch?v=luwAMFcc2f8 |

| 9. | **Muzika folklorike në stilet moderne** |
|---|---|
| | -**„Твојте очи Лено“** исполнува Баклава<br>https://www.youtube.com/watch?v=T03dEOVScMU<br>-**„Јовано, Јованке“** исполнуваат В. Стефановски и М. Тадиќ<br>https://www.youtube.com/watch?v=kyFwwIHw6nw<br>-**„Градел Илија манастир“** исполнуваат браќата Тавитјан и С. Четковоќ<br>https://www.youtube.com/watch?v=sCO6NrDMuwY<br>-**„Ја излези Ѓурѓо“** - Next Time<br>https://www.youtube.com/watch?v=12pu3mmZD_A<br>-**„Учи ме мајко карај ме“** исполнуваат В. Стефановски и М.Тадиќ<br>https://sosiski.com/post/rWa-BoInkJA/<br>-**„Јовано Јованке“** исполнува Тоше Проески<br>https://sosiski.com/post/UaywpCZBIhI/tose-proeski-jovano-jovanke-the-best-version/<br>-**„Ој девојче“** исполнуваат Т. Проески и група Синтезис<br>https://www.youtube.com/watch?v=z6yAnPOjnGc<br>**-„ Iso polifonik “/„Исо полифонија“-** R. Bisha<br>https://www.youtube.com/watch?v=bhYH4-___VM<br>https://www.youtube.com/watch?v=DIlaI-s4JEA<br>**-„Ballkaneze“ – E. Zari/„Балкански“ – E. Зари**<br>https://www.youtube.com/watch?v=v7U4I_szuH8<br>**-„Dzelem, dzelem“ - „Erdelezi“/Џелем, џелем“-„Ерделези“ сплет напеви**<br>Gipsy Casual - Djelem Djelem & Sa O Roma Dae (Cover Song)<br>https://youtu.be/lWjFBsOrf7o,<br>-**„Заспо Јанко“** исполнува М. Џачиќ<br>https://youtu.be/hCibgrsZeBI<br>**-„TRAG“ - „ Mesečina“**<br>https://www.youtube.com/watch?v=XoMGYa_vRhs<br>- **Kafu mi draga ispeci**, Amira Medunjanin i Ante Gelo uz gudački kvartet Libra<br>https://youtu.be/0HU1x3Qfgys<br>-**„MOJ DILBERE“/„Мој дилбере“** исполнува А. Медуњанин<br>https://youtu.be/0HU1x3Qfgys<br>-**„Ma fakut muma frumose“** исполнува Б. Крстиќ<br>**https://youtu.be/PG0WW4nLfi4** |

| | |
|---|---|
| | -**,,İki Keklik''/„Две еребици"**,исполнува O. Hakalmaz/О. Хакалмаз<br>https://www.youtube.com/watch?v=a5r0XDIjIzw<br>- **,,Gesi Bağlarında Dolanıyorum''/,,Шетајќи низ лозјата во Геси'',** исполнува Burçin/Бурчин<br>https://www.youtube.com/watch?v=-FKfIViS6AA<br>-**,,Yeşil Ördek Gibi Daldım Göllere'' /„Како зелена патка се занесов во езерата"**, исполнува M. Ersoy/М. Ерсој<br>https://www.youtube.com/watch?v=AMwdX8Geekc<br>-**,,Ben Seni Sevdiğimi Dünyalara Bildirdim''/„Мојата љубов кон тебе на цел свет ја искажав"**,исполнува К. Којунџу & Ш. Сам/Kazım Koyuncu & Şevval Sam<br>https://www.youtube.com/watch?v=UsNcW4EYphE<br>-**,,Leylim Ley''/,,Лејлим Леј''**- Zülfü Livaneli/Зулфу Ливанели, исполнува H. Şenlendirici/Х. Шенлендириџи<br>https://www.youtube.com/watch?v=hmXmA5GW1bI<br>-**,,Sarı Gelin''/„Жолта невеста"**, исполнува Y. Bingöl/Ј. Бингол<br>https://www.youtube.com/watch?v=FvwUwTbm_xw<br><br>- **„Potpuri" /„Потпури" Yllka Kuqi & Ylli Demaj – И. Кuќи и И. Демај**<br>https://www.youtube.com/watch?v=W7D7JVMa6bk<br>-**„Po të pres akoma"/„Сеуште те чекам",** S. Jetishi / Ш. Јетиши<br>https://www.youtube.com/watch?v=KWV991nyvFI<br>-**„Çka m'ka syri" /„Што имам во окото",** Elita 5 – Елита 5<br>https://www.youtube.com/watch?v=ZMM6kEho22U<br>-**„Moj e mira te pojata /„ Убавата кај Појата",** H. Misini-Х. Мисини<br>https://www.youtube.com/watch?v=QTDzzBf9xfQ |

| | |
|---|---|
| **REKOMANDIME DIDAKTIKE** | Përmbajtjet muzikore në arsimin muzikor për klasën XI në arsimin fillor nëntëvjeçar mundësojnë planifikimin e brendshëm integrues ndërmjet temave mësimore, si dhe planifikimin e jashtëm me lëndët tjera mësimore.<br>Tema mësimore „Aktivitetet e interpretimit" përbëhet nga këndimi, ekzekutimi në instrumentet muzikore për fëmijë, të shprehurit dhe krijimtaria muzikore të integruara ndërmjet tyre. Me këtë mundësohet shumë më lehtë interpretimi dhe realizimi i përmbajtjeve të parapara muzikore. Programi parasheh edhe mundësinë që nxënësit të njihen me numëruesit, fjalëshpejtat dhe këngët në gjuhën shqipe dhe në gjuhën e popujve tjerë të cilët jetojnë në vendin tonë përmes këndimit, ekzekutimit dhe veprimtarisë muzikore. Në shtojcë të programit është dhënë lista e këngëve (sipas dëgjimit dhe notat) prej të cilave mësimdhënësi bën përzgjedhjen për t'i realizuar gjatë vitit. Mësimdhënësi përzgjedh këngë në gjuhën që e realizon mësimin. Në temën e dytë mësimore ,,Dëgjimi i muzikës'' radhiten punime nga autorë, vende, epoka dhe stile të ndryshme (shiko Shtojcën e programit) nga të cilat mësimdhënësi mund të bëjë përzgjedhjen sipas interesave dhe nevojave të nxënësve. Tema e tretë mësimore i përthellon njohuritë nga klasat paraprake dhe aplikon përmbajtje të reja nga fusha e shkrimit muzikor. Tema e katërt i njofton nxënësit me traditat e popullit maqedonas dhe popujve tjerë të cilët jetojnënë vendin tonë, si dhe me zbatimin e muzikës popullore në zhanret e muzikës moderne.<br>Në planifikimin e përgjithshëm të përmbajtjeve të lëndës mësimore arsimi muzikor duhet të përfshihen edhe planifikimet që janë të ndërlidhura me vlerësimin e të arrituravetë nxënësve gjatë realizimit të programit muzikor. Kjo nënkupton se vlerësimi duhet të jetë pjesë edhe e planifikimeve ditore, tematike globale e procesit mësimor. Planifikimi i mësimit të arsimit muzikor duhet të jetë në koordinim me planin mësimor dhe programin për këtë lëndë dhe t'i përfshijë përmbajtjet programore nga të gjitha temat. Gjatë realizimit të programit mësimor të arsimit muzikor mësimdhënësi duhet ta shpërblejë nxënësin me fjalë motivuese, sepse bëhet fjalë për lëndë mësimore ku përveç tjera nxënësi duhet të ketë edhe talent, pasion. |
| **Vlerësimi i të arriturave të nxënësve** | **KONTROLLIMI DIAGNOSTIK**<br>Në fillim të vitit shkollor mësimdhënësi bën kontrollimin diagnostik me qëllim të njohjes së gjendjes ashtu siç është, në funksion të planifikimit dhe realizimit cilësor të aktiviteteve vijuese. Kontrollimin diagnostik mësimdhënësi mund ta realizojë me zbatimin |

| | |
|---|---|
| | e më shumë instrumenteve siç janë: testet diagnostike dhe pyetjet me gojë. Përgjigjet e fituara janë pasqyrë e njohurive paraprake të nxënësit të kuptimit më të gjerë të fjalës dhe paraqesin bazë për planifikimet rreth realizimit të programit mësimor dhe procesit të vlerësimit gjatë vitit mësimor.<br><br>**VLERËSIMI FORMATIV**<br>Gjatë mësimit të arsimit muzikor në **klasën e nëntë** rekomandohet ndjekja formative e cila do të mundësojë formimin e përshkrimeve objektive si informatë kthyese për të arriturat e nxënësve në një periudhë të caktuar kohore.<br>Ndjekjen formative e të arriturave të nxënësve mësimdhënësi mund ta realizojë me zbatimin e metodave të ndryshme për vlerësim:<br>• biseda mësimdhënës-nxënës;<br>• prezantime gojore;<br>• detyra shtëpie;<br>• mbledhje e punimeve të fëmijëve, krijime, deklarata dhe ngjashëm nga nxënësit;<br>• punime të fëmijëve, krijime, deklarata etj., duhet të jetë në dispozicion të prindërve gjatë gjithë vitit në mënyrë që ata të kontribuojnë në mësimdhënie cilësore;<br>• veprat e zgjedhura, krijimet, deklaratat etj., përcillen në klasën vijuese më të lartë.<br>**VLERËSIMI SUMATIV**<br>Në bazë të vlerësimit formativ formohen notat numerike formative. Gjatë vitit shkollor nxënësit vlerësohen më së paku me dy nota gjatë një gjysmëvjetori, ndërsa përcaktohen me notat e gjysmëvjetorit dhe vjetore. Vlerësimi i të arriturave të nxënësve është me notë numerike (prej 1 deri 5).<br>VËREJTJE: Gjatë mësimit rregullisht ndiqen dhe vlerësohen të arriturat e nxënësve, mblidhen treguesit e aktiviteteve të tyre, motivimi e paraqitjes muzikore, angazhimi i nxënësve, përkushtimi në punë, si dhe puna ekipore. Gjatë ndjekjes së të arriturave të nxënësve, mësimdhënësi dhe në veçanti të ketë kujdes në qasjen individuale te secili nxënës. Vazhdimisht i ndjek, vlerëson dhe noton aktivitetet, veprimtarinë e nxënësit dhe implementimin e njohurive të tija, sjelljen e nxënësit dhe rezultatet e arritura në sferën e njohurive, mundësive dhe ndryshimet pozitive në karakterin e personalitetit të nxënësit. Për kontrollimin e të arriturave, Rezultatet e mësimit do të zbatohen kontrollimet me gojë dhe me shkrim , fleta pune (kontrollimi i temave)dhe mjete tjera, procedura dhe metoda, psh., instrumente për vlerësim (çek lista, shkalla deskriptive, analitike etj.,) informatë kthyese (gojore dhe me shkrim) etj. |
| **Kushtet materiale-teknike dhe hapësinore** | Për të arritur qëllimet e arsimit muzikor është e nevojshme që të keni një program profesional dhe të planifikuar profesional të ndihmave të ndryshme mësimore, si dhe një kabinet muzikor të mobiluar me ndihmat e mëposhtme mësimore: sistem muzikor, televizor, DVD, kompjuter me pakete programore përkatëse me programe muzikore, Smart - tabelë, fonotekë (përmbledhje të audio-video CD), instrumente muzikore për fëmijë etj. Për një realizim të sukseshëm dhe të përgjithshëm të programit muzikor |

| | |
|---|---|
| | e nevojshme është të organizohen edhe aktivitete të cilat e ndryshojnë vendin e realizimit të orës/orëve (institucionetë kulturës dhe institucione tjera), ku nxënësit do të ndjekin ngjarje: koncert, operë, balet dhe evinimente tjera muzikore.<br>Për shembull: vizitë në Orkestrën Filharmonike të Maqedonisë, Opera dhe Baleti i Maqedonisë, Instituti Kombëtar i Ansamblit të Valleve dhe Këngëve Popullore ,,Tanec", shoqata kulturore dhe artistike dhe institucione të tjera kulturore. |
| **Literatura dhe burime tjera** | **Për realizimin e programit mësimor të domosdoshme janë:**<br>• libri i lejuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës;<br>• leksikone muzikore;<br>• enciklopedi muzikore;<br>• përmbledhje të kompozimeve vokale-instrumentale ose rezultateve individuale;<br>• përmbledhje të këngëve popullore dhe valle;<br>• literaturë e llojit tjetër i rëndësishëm për realizimin e programit;<br>• Interneti, softuere muzikore. |

## NORMATIVI I KUADRIT MËSIMOR

Mësimin e lëndës arsimi muzikor mund ta realizojë individi që ka të kryer:
- studime të artit muzikor – drejtimi për teori muzikore dhe pedagogji, VII/1 ose 240 SETK;
- studime të artit muzikor, drejtime tjera, VII/1 ose 240 SETK, dhe me trajnime të fituara pedagogjike-psikologjike dhe metodologjike të një institucioni të arsimit të lartë të akredituar.

## FILLIMI I ZBATIMIT TË PROGRAMIT MËSIMOR

**Data e fillimit: 01.09.2019**

## NËNSHKRIMI DHE DATA E PËRCAKTIMIT TË PROGRAMIT MËSIMOR

Programin mësimor për **arsimin muzikor** për klasën IX (nëntë) në arsimin fillor nëntëvjeçar, me propozim të Byrosë së zhvillimit të arsimit, e përcaktoi

Numër 12-5388/1
10. 05.2019

**MINISTËR**,

________________________

**Dr. Arbër Ademi**

Përpiloi: grupi punues, bashkërendues dr. Ankica Vitanova, udhëheqëse njësie
Kontrolloi: Trajçe Gjorgjijevski, udhëheqës njësie
Lejoi: mr. Mitko Çeshlarov, udhëheqës sektori